REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**
**KËSHILLI I BASHKISË LEZHË**

**VENDIM**

**Nr.**43 **Datë**29.03**.2019**

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL NË BASHKINË LEZHË"**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërise" neni 36 pika 'c' , Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.111 datë 23.2.2018 për krijimin dhe funksionimin e fondit social, Këshilli i Bashkisë Lezhë pasi shqyrtoi draft planin e pergatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social,

**V E N D O S I :**

I. Miratimin e Planit Social në Bashkinë Lezhë .

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**
**Kristian GJIDODAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË -

Ligji Nr.139/2015 për ‘‘Vetëqeverisjen Vendore’’, ngarkon Njësitë e Pushtetit Vendor me përgjegjësi të reja dhe të rëndësishme në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, ku theksohet qartë funksionimi i sistemit të ri të kujdesit shoqëror. MSHKS zhvillon politikat dhe përcakton prioritetet, por janë bashkitë ato që kanë përgjegjësitë kryesore për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. MSHKS, bazuar në VKM Nr.111, datë 23.02.2018, nëpërmjet fondit social ka përgjegjësine dhe detyrimin për të parashikuar në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror bazuar në planet sociale të bashkive. Strategjia kombëtare për mbrojtjen sociale 2015-2020, paraqet një orientim të qartë politikash për kujdesin shoqëror, me qëllim që të identifikojmë çështjet kyçe që duhen adresuar për të ndërtuar një sistem funksional.

Në kuadër të kësaj, Bashkia Lezhë ka marrë përsipër hartimin e planit social, i cili është në funksion të fondit social. Gjatë gjithë këtij proçesi, Bashkia Lezhë është mbështetur nga World Vision dhe ESA Consulting në vlerësimin e nevojave lidhur me hartimin e planit, buxhetimit të tij dhe identifikimjn e burimeve financiare për ta zbatuar.

**PLANI SOCIAL VENDOR 2018-2021**

**Bashkia Lezhë**

Plani social i Bashkisë Lezhë.

Ky plan është hartuar në bashkëpunim me ESA Consulting dhe Bashkinë Lezhë, e mbështetjen e WVA.

Korrik 2018

## PËRMBAJTJA

## HYRJE

Që nga viti 2015 e më tej, ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"" ka ngarkuar njësitë e pushtetit vendor me një sërë përgjegjësish të reja e të rëndësishme në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke qenë se për shkak të afërsisë me komunitetin, niveli vendor konsiderohet si ai më përshtatshmi për ofrimin e shërbimeve shoqërore për përfituesit. Këto shërbime përfshijnë ofrimin e shërbimeve shoqërore komunitare, shqyrtimin dhe vendimmarrjen në lidhje me procedurat për marrjen në kujdestari, si dhe, në raste të caktuara, menaxhimin e shërbimeve rezidenciale. Po kështu, legjislacioni përcakton detyrimet specifike për shërbimin shoqëror në nivel vendor, që përfshijnë edhe ngritjen e Njësive të Mbrojtjes së Fëmijës (NJMF) dhe pikave fokale për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje.

Shërbimet e kujdesit shoqëror konsiderohen si funksion i vetë pushtetit vendor, sipas Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015 – 2020), në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore. Kjo strategji shpreh synimin e qeverisë për decentralizimin e plotë të shërbimeve të kujdesit shoqëror, me mbështetjen teknike, institucionale dhe financiare të burimeve të buxhetit të shtetit.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 paraqet një orientim të politikave për kujdesin shoqëror, me qëllim reformimin e sistemit, duke theksuar se 'fillimisht identifikojmë çështjet kyçe që duhen adresuar për të ndërtuar një sistem funksional, dhe së dyti përdorim një qasje me faza për ta zhvilluar këtë sistem'. Në fazën e parë, fokusi vendoset në ndërtimin e themeleve për të lejuar pilotimin e sistemit të ri të shërbimeve të kujdesit shoqëror në rajone të caktuara.

Deri më sot, pas tre viteve reformë administrative-territoriale, Bashkitë po ecin drejt përmirësimit dhe shtimit të elementëve kyç që përbëjnë gjithë proçesin e ofrimit të shërbimeve soiale:

1. Evidentimin e shërbimeve sociale ekzistuese si dhe studimin për nevojën dhe domosdoshmërinë e shërbimeve të reja, duke i prioritizuar ato.
2. Role dhe përgjegjësi të qarta për bashkitë e formuara rishtazi për planifikimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat janë pasqyruar në ligjin e ri për vetëqeverisjen vendore, strategjine e decentralizimit dhe atë të mbrojtjes sociale si dhe detyrimin e MSHKS për bashkëfinancimin e këtyre shërbimeve.
3. Formësimi i konceptit të paketës bazë të shërbimeve (shportës), në bashkëpunim me MSHKS dhe njësitë e qeverisjes vendore.
4. Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe draft VKM-të po shtrojnë bazën ligjore, në mënyrë që sistemi të funksionojë. Në këtë fazë, aktet nënligjore duhet të hartohen e miratohen sa më shpejt me qëllim që gjithçka e parashikuar në ligj të jetë e zbatueshme dhe funksionale.

Përmes këtyre themeleve qartësohet funksionimi i sistemit të ri të kujdesit shoqëror: MSHKS zhvillon politikat dhe përcakton prioritetet, por janë Bashkitë ato që kanë përgjegjësinë kryesore për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Dhe më e

rëndësishmja, MSHKS, bazuar në VKM 111 datë 23.2.2018, nëpërmjet Fondit social ka përgjegjësinë dhe detyrimin për të parashikuiar në buxhetin e saj fonde për financimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, bazuar në planet sociale të bashkive.

Në këtë kuadër, Bashkia e Lezhës merr përsipër hartimin e Planit Social, të prezantuar në këtë dokument. Përgjatë këtij proçesi, ajo është mbështetur nga World Vision dhe ESA Consulting, në vlerësimin e nevojave lidhur me hartimin e planit, buxhetimin e tij dhe identifikimin e burimeve financiare për ta zbatuar, duke rritur kapacitetet vendore në këtë drejtim.

## 1. SHËRBIMET SHOQËRORE EKZISTUESE NË BASHKINË E LEZHËS

Aktualisht, Bashkia Lezhë, në bashkëpunim me organizatat jofitimprurese, ofron këto shërbime të kujdesit shoqëror:

| NR. | EMRI I SHËRBIMIT | PËR CILIN TARGET GROUP | ÇFARË SHËRBIMESH OFRON (PËRMBLEDHJE) | KUSH E OFRON SI SHËRBIM | VITI I FILLIMIT TË VEPRIMTARISË NE TERRITORIN E BASHKISË LEZHËS |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Qendra Ditore për të moshuarit** | Mosha e tretë | • Mbështetje psiko-emocionale<br>• Aktivitete rekreative dhe socializuese. | Bashkia Lezhë /Kryqi i kuq | 2008 |
| **2** | **Qendra Komunitare "Jozue"** | Fëmijët | • Kopsht për fëmijët e familjeve në nevojë<br>• Programe përgatitore për fillimin e klasës së parë, për fëmijët 3-6 vjeç<br>• Aktivitete argëtuese dhe zhvilluese për fëmijët gjatë vitit shkollor | Qendra Jozue | 2007 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3 | **Qendra Komunitare “Santa Maria”** | Fëmijët në vështirësi (me fokus të veçantë fëmijët e Komunitetit Rom dhe Egjiptian) | • Aktivitet passhkollor, tre herë në javë nga 2 orë, për të ndihmuar fëmijët të përmbushin detyrat dhe në angazhimin e tyre shkollor<br>• Mbështetje financiare mujore për fëmijët që frekuentojnë qendrën (3000 lekë çdo fëmijë)<br>• Mbështetje me mjete didaktike, libra, fletore, çanta, etj<br>• Takime mujore me prindërit e fëmijëve që<br>• frekuentojnë qendrën, për të diskutuar mbarëvajtjen shkollore të fëmijëve të tyre dhe tema edukative<br>• Zhvillimin e kurseve të gjuhëve të huaja (për klasat e V, VI, VII, VIII)<br>• aktivitete sportive teatrale, kampe verore për t’i ndihmuar fëmijët të shprehin aftësitë e tyre si dhe për t’i përfshirë dhe integruar në jetën e shoqërisë<br>• Mësim kompjuteri<br>• Pagesën e shpenzimeve çdo muaj për fëmijët e lartpërmendur që frekuentojnë çerdhen dhe kopshtin. | Qendra Komunitare “Santa Maria” | 2004 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | **Mary Ëard Loreto** | Gratë dhe vajzat | • Trajnime profesionale per fuqizimin e grave dhe vajzave (me qëllim krijimin e mundësive për punësim, me fokus të veçantë tek gratë dhe vajzat në nevojë), si rrobaqepësi, kuzhinë, etj<br>• Asistencë, ndjekje dhe mbështetje për rehabilitimin e viktimave të trafikimit<br>• Kampe verore për vajza (për fuqizimin e vajzave)<br>• Mbështetje për rastet e grave të dhunuara. | Mary ËËard Loreto | 2014 |
| 5 | **Caritas** | Personat me Aftësi të Kufizuara | Projekti kryesor në Lezhë është qendra e këshillimit të personave me aftësi të kufizuar për aftësimin e tyre për të kërkuar të drejta të barabarta për punësim. | CARITAS | 1992 |
| 6 | **Observatori i të drejtave të fëmijëve** | Fëmijët nga 1-18 vjeç | Observatori monitoron situatën e të drejtave të fëmijëve nga niveli lokal në atë qendror. | Entitet i shoqërisë civile. i themeluar nga UNICEF | 2012 |
| 7 | **Ambasadorët e Paqes** | Të rinjtë e zonës së Zadrimës | • Aktivitete edukuese jo formale<br>• Kampe verore<br>• Aktivitete pas shkollore<br>• Shkëmbime rinore me programe si Erazmus+<br>• Kurse kërcimi, gjuhe të huaj, recitimi etj<br>• Aktivitete sensibilizuese dhe ndërkulturore<br>• Takime me fëmijët e ngujuar dhe advokim me organet përkatëse për t'iu mundësuar atyre daljen e lirë dhe shkollimin<br>• Takime sensibilizuese nëpër shkolla për të diskutuar rreth fenomeneve shqetësuese për të | Mbështetur nga Caritas Italia | 1997 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | rinjtë.<br>• Ofron syze optike, bazuar mbi rekomandimin e okulistit, në bashkëpunim me NJMF-në në Bashki. | | |
| 8 | **Ëorld Vision** | Fëmijët deri në 18 vjeç, familjet e tyre | Ëorld Visionnë Lezhë punon me projektin e Edukimit, Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Sponsorship-it, në 5 njësi administrative (Kallmet, Kolsh, Zejmen, Balldre dhe Shën Koll).<br>• Në projektin e Edukimit mbështet shkollat për të zbatuar modelin e Shkollave si qendër komunitare, për të zhvilluar plane veprimi dhe për të mobilizuar komunitetin për përmirësimin e standarteve të SHQK. Gjithashtu punon për rritjen e kapaciteteve të strukturave të shkollave. Brenda këtij projekti, është prioritet përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar në sistemin arsimor. Ka filluar ndërtimi i klasave burimore në 10 shkolla të Lezhës, ku do të ofrohen shërbime të ndryshme për këta fëmijë.<br>• Në projektin e Mbrojtjes së fëmijëve, ËV punon për të rritur kapacitetin e fëmijëve dhe të rriturve për sistemin e referimit dhe raportimit të rasteve të mbrojtjes.<br>• Në projektin e Sponsorshipit, Lezha ka të regjistruar 2400 fëmijë, në 5 njësitë administrative. Këta fëmijë marrin pjesë në aktivitete të ndryshme zhvilluese dhe kanë korrespondencë me sponsorët e tyre në Britaninë e Madhe. | Ëorld Vision dhe Bashkia Lezhë | 1999 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | **Qendra Komunitare për përmirësimin e kushteve të jetesës për fëmijët dhe familjet e kthyer nga emigracioni** | Familjet e rikthyera nga emigracioni, si dhe familjet në rrezik për emigrim, me fëmijë deri në 18 vjeç. | • Fuqizim ekonomik, ndjekje e fëmijëve në nevojë për mbrojtje<br>• Aktivitete sensibilizuese, këshilluese për prindërim pozitiv<br>• Lojra psiko-sociale<br>• Mbështetje shkollore. | Bashkia Lezhë<br><br>Ëorld Vision<br><br>Terre des hommes | 2017 |
| 10 | **Qendra Laura Vikunja –Tale** | Të rinjtë dhe komuniteti | • Aktivitete psiko-sociale<br>• Qendër ditore për fëmijët parashkollorë<br>• Kurse promocionale për vajzat dhe nënat e reja të zonës së Tales. | Motrat Saleziane | 2004 |
| 11 | **Qendra Rozalba** | Fëmijët në risk, me fokus vajzat e grupmoshës 14-18 vjeç | • Qendër rezidenciale për vajzat e grupmoshës 14- 18 vjeç, në rrezik trafikimi apo të cilat vijnë nga situata të dhunës në familje<br>• Shërbime përkujdesi<br>• Aktivitete të ndryshme psiko-sociale. | Motrat Venerini | 2014 |
| 12 | **Qendra rezidenciale e Lumja Marie Tuci** | Gratë dhe fëmijët në nevojë | • Strehim i sigurt për gratë dhe fëmijët në nevojë<br>• Kurse gjuhësh dhe kompjuteri<br>• Shërbime psikologjike. | Familja Rregulltare e “Fjalës së Mishëruar” | 2011 |
| 13 | **Qendra Komunitare Multidisiplinare Malteser** | Komuniteti Rom dhe Egjiptian/Shtresa të tjera në nevojë | • Qendër ditore për parashkollorët<br>• Mbështetje shkollore për fëmijët që kanë nevojë për asistencë në mësime dhe detyra<br>• Konsulencë psikologjike dhe juridike për komunitetin<br>• Kurse kundër analfabetizmit<br>• Qendër sportive për komunitetin | Malteser Shqipëri<br><br>Bashkia Lezhë | 2017 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |

## 1.1. Projekte/iniciativa që po zbatohen nga partnerët - apo që do të fillojnë në tre vjeçarin e ardhshëm

| Nr | Titulli i projektit | Organizata Zbatuese | Donatori | Partnerët | Përfituesit | Zona e zbatimit | Kohëzgjatja | Buxheti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **PROJEKTE QË KANË NË FOKUS MBROJTJEN E FËMIJËVE** | | | | | | | | |
| **1.** | "Përmirësimi Kushteve të Jetesës për Fëmijët Migrantë në Shqipëri". | -Terre des hommes<br>-Ëorld Vision | -Terre des hommes<br>-Ëorld Vision<br>-Agjencia Austriake, ADA | -Bashkia Lezhë<br>-Ëorld Vision<br>-Terre des hommes | Familjet në nevojë me fëmijë nën 18 vjeç të rikthyer nga emigracioni (Gjermania) | Në Bashkinë Lezhë | Prill 2016 deri Mars 2019 | Bashkia ofron: 1200 Euro në vit për ambientin; 48 000 Lek në vit për pagesën e ujit dhe të dritave |
| 2 | "Mbështetja e familjeve, fëmijëve dhe të | -Terre des hommes<br>-Ëorld Vision | -Terre des hommes | -Bashkia Lezhë<br>-Ëorld Vision | Familje, fëmijë dhe të rinj, ekspozuar ndaj | Në Bashkinë Lezhë. | Tetor 2017-Shtator 2018 | Projekti GIZ<br>Bashkia ofron: ambientin; dy |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | rinjve, ekspozuar ndaj migrimit në Lezhë dhe Shkodër”. | | -Ëorld Vision<br><br>-Qeveria Gjermane, GIZ | -Terre des hommes | migrimit. | | | punonjëse, 516000 Lek në vit. |
| **3** | “Askush të mos mbetet pas” | **-**Kombet e Bashkuara në Shqipëri<br><br>-Ambasada e Zvicrës | **-**Kombet e Bashkuara në Shqipëri<br><br>-Ambasada e Zvicrës | Fondacioni “Ndihmë për fëmijët | Fëmijët vajza e djem, të rinjtë e të rejat, familjet dhe komunitetet Rome dhe Egjiptiane. | Në Bashkinë Lezhë | Nëntor 2017-Maj 2021 | Bashkia ofron ambientin, 600 Euro në vit. |
| **PROJEKTE PËR PAK** | | | | | | | | |
| **1** | Caritas<br><br>Inclusion , Instalim, rrjetëzim dhe ngritje kapacitetesh përmes këshillimit ligjor dhe ndërhyrjeve strategjike të unifikuara, lidhur me nevojat e | Caritas Shqiptar | Caritas Austria, Austrian Development Cooperation | Shoqatat dhe Shoqëria Civile | Personat me Aftësi të Kufizuar/Kujdestarët e tyre. | Lezhë | **Shtator 2017-gusht 2020.** | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri. | | | | | | | |
| **2** | | | | | | | | |
| **PROJEKTE PËR FUQIZIMIN E VAJZAVE DHE GRAVE** | | | | | | | | |
| **1** | Shtëpia OLA | Shoqata Opera e Life Onlus Trento, Rajoni Alto Adige, FondacioniCariveron a. | Opera e Life O.N.L.U.S | Bashkia Lezhë, Shoqata Operae Life Onlus Trento, Rajoni Alto Adige, Fondacioni Cariverona | Gratë dhe fëmijet e Qarkut Lezhë | Lagjia “Nënë Tereza”, Lezhë | Fillimi i punimeve në Mars 2016. Mbarimi i punimeve në Shtator 2017 | 30.000 euro nga Bashkia Lezhë, 470.000 Lek të financuara nga Shoqata Operae Life Onlus Trento, Rajoni Alto Adige, Fondacioni Cariverona<br><br>Truall i ofruar nga Bashkia Lezhë (në vlerën 25.533.000 Lek) |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| **2** | Fuqizimi i gruas në tregun e punës | Kryqi i Kuq Shqiptar,<br>Dega Lezhë | -Kryqi i Kuq Shqiptar<br>- Mary Ëard Loreto<br>-Terre des hommes<br>Bashkia Lezhë | -Kryqi Kuq Shqiptar<br>-Mary Ëard Loreto Bashkia Lezhë<br>-Zyra e punës Lezhë<br>-Shoqata Celsi im Shërbimi Social Shtetëror Rajonal Lezhë<br>-Fasoneritë | 30 përfituese | Lezhë | Që nga viti 2009 | 682 000 Lek |
| **3** | Fuqizimi i Grave dhe Vajzave | Mary Ëard Loreto, Projekti i grave | Fondacioni Mary Ëard Loreto | Njësia Administrative Kallmet, Lezhë | Gratë dhe vajzat | Kallmet, Barbullojë<br>Gjadër<br>-raste sporadike që paraqiten për mbështetje nga zona të ndryshme të Lezhës | Nga viti 2014 e në vazhdim | - |
| **4** | Fuqizimi i burrave | Mary Ëard Loreto, projekti i burrave | Fondacioni Mary Ëard Loreto | Grup i burrave dhe të rinjve, Kallmet | Burra dhe të rinj | Kallmet dhe Lezhë | Viti 2017 e në vazhdim | - |
| **5** | Aktivizimi i | Gruaja Vizioni i | Lëviz Albania | Bashkia, njësitë | 50 gra të5 NJA | BASHKIA | 7 muaj | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | mekanizmave të pjesëmarrjes së grave në procesin e vendimmarrjes , nëpërmjet formalizimit të grupeve 15locale për zhvillim**.** | Ndryshimit | | Administrative | në Bashkinë Lezhe | LEZHË | | |
| **PROJEKTE PËR MOSHËN E TRETË** | | | | | | | | |
| 1 | Ndihma e Parë | Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Lezhë | Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Lezhë | -DAR<br>-Shëndeti Publik<br>- Inspektoriati i Punës<br>-Biznese private | 500 | Lezhë | Që nga viti 2005 | 150 000 Lek |
| | Qendra ditore e moshës së tretë | Kryqi i Kuq Shqiptar Dega Lezhë | Kryqi Kuq Shqiptar dhe Bashkia Lezhë | -Kryqi i Kuq Shqiptar dhe Bashkia Lezhë<br>-Shërbimi social<br>-Shëndeti publik<br>-Biznese private<br>-DAR Lezhë | 100 | Lezhë | Që nga viti 2008 | 637 000 Lek |
| **PROJEKTE PËR FUQIZIMIN E FAMILJES** | | | | | | | | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2** | Familje në nevojë | Kryqi i Kuq Shqiptar Dega Lezhë | Kryqi i Kuq Shqiptar dhe Bashkia Lezhë | -Bizneset<br>-Entreaide internacionale Kksh | 500 | Lezhë | Që nga viti 2004 | 5000 Lek + donacione në natyrë |
| **3** | Shëndeti në komunitet | Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Lezhë | Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Lezhë | -Shëndeti Publik<br>-DAR | 150 | Lezhë | Që nga viti 2004 | 100 000 Lek + donacione në natyrë |
| **PROJEKTE PËR TË RINJTË** | | | | | | | | |
| **1** | Seancë informimi për : Drogën, SIDA, alkooli, duhani, | Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Lezhë | Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Lezhë | -Shëndeti Publik<br>-DAR<br>-Prefektura<br>-Shërbimi Social | 700 | Lezhë | Që nga viti 2004 | 100 000 Lek |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | -Higjiena në komunitet<br>-Higjiena në familje | | | Rajonal | | | | |
| **2** | Projekt pranë Bashkisë Lezhë me të rinjtë (përmirësimi i mirëqeverisjes) | ANTARCH, Mary Ëard Loreto, Projekti i të rinjve | -ANTARCH,<br>-Mary Ëard Loreto | Bashkia Lezhë (disa drejtori), Projekti it ë rinjve Mary Ëard Loreto | Grup të rinjsh, studentë dhe gjimnazistë | Bashkia Lezhë dhe Njës17itë Administrative | 10 muaj (nëntor 2017-gusht 2018) | - |
| **3** | Projekt me gjimnazistët(Shkolla Ragacionistët) | Fondacioni Mary Ëard Loreto | Mary Ëard Loreto | DAR, Mary Ëard Loreto, Shkolla Ragacionistët | -Gjimnazistë<br>-Stafi Pedagogjik<br>-Komuniteti i të rinjve lezhjanë | Gjithë komuniteti Lezhjan (nëpërmjet fuqizimit të të rinjve) | 10 muaj (nëntor 2017- gusht 2018) | - |
| | Rrjeti Rinor Lezhë, Lezha Youth Netëork Leyonet | Shoqata Dora e Pajtimit | Bashkia Lezhë | Bashkia Lezhë<br>Dora e Pajtimit<br>UNDP | Të rinjtë e grupmoshës 18-25 ( komuniteti i Lezhës në tërësi) | 10 Njësitë administrative në Bashkinë Lezhë | Maj 2018-janar 2019 | 2,648,775 Lek vlera totale e projektit, nga të cilat 695,304 Lek janëkontribut i Bashkisë |
| | Sporti për integrim dhe zhvillim te qendrueshem | Qendra e Studimeve dhe Zhvillimeve. | Bashkia Lezhë | Bashkia Lezhë<br>UNDP<br>Qendra e Studimeve | Të rinjtë dhe gratë e zonës | 1 Njësi administrative + Gjimnazi “Hydajet | Maj 2018-janar 2019 | 3,478,621 Lek ( total) nga e cila 913.138 Lek janë kontribut i |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe Zhvillimeve | | Lezha”-qytet Lezhë | | Bashkisë |
| **PROJEKTE PËR NGRITJE KAPACITETESH/FORCIM BASHKËPUNIMI ME FOKUS SHËRBIMET SOCIALE** | | | | | | | | |
| **1** | Qendër Multi-disiplinore Social-Mjekësore në shërbim të Komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe shtresave të tjera në nevojë. | Organizata e Urdhërit të Maltës | Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës | Organizata Shqiptare e Urdhërit të Maltës | Komuniteti Rom dhe Egjiptian dhe shtresat e tjera në nevojë | Lagjia “Skënderbeg ”, Lezhë | 06.03.2017-22.11.2017 | 85.000 Euro me TVSH<br>Trualli i ofruar nga Bashkia Lezhë, si dhe paga e dy sanitareve, 440.000 Lek në vit |
| **2** | Të gjitha projektet e fondacionit Mary Ëard Loreto adresojnë fuqizimin ekonomik dhe social të grupeve me të cilat punojnë | Mbështetje ligjore, adresim të çeshtjeve të të drejtave të grave, për punësimin, kurset profesionale, shkollim, mbështetje psikologjike. | | | | | | |

## 1.2. Prioritetet në zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor

Bashkia e Lezhës, bazuar mbi vlerësimin e nevojave për shërbime në territorin e saj dhe përmes diskutimeve me stafin dhe aktorët relevante, si dhe mbi shportën e shërbimeve bazë, liston prioritetet e mëposhtme në zhvillimin e shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe atyre të reja dhe i reflekton ato në planin e veprimit 2018-2021:

Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale (Neni 24 i Ligjit 139/2015 "Për veteqeverisjen vendore.

**Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese:**

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara dhe shtrirja e tyre në çdo njësi administrative, në përgjigje të nevojave të qytetarëve.
- Informimi i qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre dhe nga të cilat mund të përfitojnë.
- Informimi i aktorëve relevantë mbi rolet e përgjegjësive të secilit, në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

**Zhvillimi i shërbimeve të reja:**

- Shërbime në nivel njësie administrative; qendra multifunksionale komunitare nën varësinë e bashkisë; shërbime sa më të larmishme, edhe parandaluese, për të gjitha kategoritë vulnerabël të identifikuara, si për fëmijët dhe të rriturit, shërbime lëvizëse dhe shërbime në familje.
- Qendra emergjence dhe shërbime 24 orëshe për personat në nevojë për mbrojtje.
- Ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e shërbimeve të kujdesit alternativ.
- Shërbime terapeutike për fëmijët me sindromën Daun apo me çrregullime të spektrit autik nga 0-6 vjeç.
- Ngitja e qendrave të moshës së tretë në çdo njësi administrative
- Qendra ditore për personat e pastrehë, të moshuarit, fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara (veçanërisht mbi 21 vjeç), personat me probleme të shëndetit mendor, etj.
- Ngritja e strehëzës dhe ofrimin e shërbimeve që synojnë fuqizimin e viktimave të dhunës në familje.
- Ndërtimin e shërbimeve për fuqizimin e personave në nevojë, sidomos për të rinjtë romë dhe egjiptianë, dhe familjet që marrin ndihmë ekonomike.

## 2. ANALIZA E AKTORËVE TË PËRFSHIRË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

### 2.1. Situata e mbrojtjes shoqërore në bashkinë e Lezhës

Drejtuesit dhe stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social (DSHS-së), NJA-ve, përfaqësuesit e SHSR-së, shërbimit psiko-social shkollor si dhe OJF-të që veprojnë në territorin e bashkisë Lezhë, identifikojnë një sërë sfidash dhe nevojash, të lidhura me performancën në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke marrë parasysh edhe reformën territoriale dhe legjislacionin relevant, si më poshtë:

- Së pari, Bashkia Lezhësiguron ofrimin eshërbimeve të kujdesit shoqëror në territor përmes OJF-ve, mbeshtetjës së donatorëve dhe stafit të drejtorisë sëshërbimit social. Ngritja e katër qëndrave komunitare, si: Qendra Komunitare për përmirësimin e kushteve të jetesës për fëmijët dhe familjet e kthyer nga emigracioni në bashkëpunim me Tdh dhe ËV; Qendra Ditore e të moshuarve në bashkëpunim me Kryqin e Kuq dhe Qendra Komunitare Multidisiplinare për fuqizimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkëpunim me Malteser dhe Qendra e Shëndetit për gruan dhe fëmijët, janë shembuj të angazhimittë Bashkisë Lezhë ndaj nevojave në rritje të komunitetit. Këto qendra deri më tani administrohen në bashkëpunim me Bashkinë Lezhë. Bashkia Lezhë ka vënë në dispozicion ambientin ku ngrihet qendra, mbulimin e pagesavetë energjisë elektrike, si dhe staf, sipas marrëveshjes me OJF-të.
- Ofrimi i ndihmës ekonomike merr kohën më të madhe të punës së administratorëve social nëNJA-ve.
- Buxheti i kufizuar është një pengesë në ofrimin e shërbimeve, e identifikuar nga të gjithë aktorët. Për këtë nevojitet qëfunksionet reja të pushtetit vendor në fushën e shërbimeve sociale, të mbështeten dhe me buxhet të përshtatshëm dhepërmes Fondit Social.
- Kufizimet e lartpërmendura dhe qasja e deritanishme në administrim kanë rezultuar edhe në informacionin e pamjaftueshëm të qytetarëve mbi shërbimet ekzistuese të kujdesit shoqëror të ofruara nga bashkia e partnerët e saj.
- Mungesa e koordinimit mes aktorëve relevantë në sektorë të tjerë është një tjetër sfidë e identifikuar nga kontribuesit në hartimin e planit. Raportohet për mosnjohje të roleve e përgjegjësive prej këtyre aktorëve (si shëndetësia, arsimi, policia), të cilat çojnë në sfida të vazhdueshme në ndjekjen e rasteve. Nga ana tjetër, ka nevojë për një vëmendje të veçantë, si në DSHS ashtu dhe NJA, përmesorganizimit tëtakimeve informuese dhe ndërgjegjësuese të vazhdueshme rreth roleve e përgjegjësive të secilit, dhe detyrimeve të përbashkëta që lindin nga legjislacioni ekzistues, në kuadrin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.
- Qasja ndaj ofrimit të shërbimeve duhet të ketë në fokus individin dhe familjen. Kjo mund tëarrihet përmes modelit të menaxhimit të rastit dhe punës ndërsektoriale, si në nivel Drejtorie të Shërbimit Social, po ashtu dhe në nivel NJA-je, si dhe në nivel ndërinstitucional, mes aktorëve të tjerë relevantë publikë dhe jopublikë, duke reflektuar kështu edhe ndryshimet legjislative të fundit, veçanërisht në lidhje me ligjin e ri për shërbimet e kujdesit shoqëror. Nevoja për ndryshim të qasjes reflektohet si në trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, ashtu dhe në ato të dhunës në familje, apo

personat me aftësi të kufizuar (vështirësitë e të cilëve për të aksesuar edhe shërbimet ekzistuese shtohen, në kushtet e infrastrukturës së munguar).

- Ndryshimi i qasjes në ofrimin e shërbimeve është parësor, në kuadrin e zbatimit të ligjit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe në prag të VKM-ve të tij, që do të bëjnë të mundur zbatimin. Detyrimi i bashkive në këtë drejtim bëhet edhe më i gjerë, duke përfshirë të gjithë personat në nevojë që pritet të trajtohen përmes menaxhimit të rastit, në NJVNRR, përmes punonjësve socialë që do të punësohen me këtë qëllim. Nga ana tjetër, këto detyrime të reja pritet të mbështeten nga pushteti qendror përmes Fondit Social për shërbimet, krahas miratimit të legjislacionit mbështetës.

## 2.2. Situata e grupeve vulnerabël dhe nevojat e tyre për shërbime

Kontribuesit në hartimin e planit raportojnë nevojën për ndërtimin e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror nga bashkia, për t'iu përgjigjur nevojave të shumta dhe të adresuara plotësishtderi më tani, të qytetarëve - fëmijë e të rritur. Nevojat prioritare për shërbime variojnë sipas grupeve të kontribuesve, pasi një vlerësim dhe diskutim i përbashkët i tyre në lidhje me shërbimet sociale deri tani ka qenë i pamjaftueshëm. Në përgjithësi këto nevoja përfshijnë:

- Zhvillimin e shërbimeve të reja, për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit, aty ku ai jeton, pas një vlerësimi të thelluar se ku është më e nevojshme të hapen, bazuar në numrin e pjesëmarrësve të mundshëm dhe burimeve.Konkretisht ndërtimin e qendrave multifunksionale komunitare dhe shëbimeve lëvizëse, nën varësinë e bashkisë, të cilat ofrojnë shërbime, sa më të larmishme, përfshirë edhe ato parandaluese, për të gjitha kategoritë vulnerabël të identifikuara, si për fëmijët dhe të rriturit. Shërbimet lëvizëse do të mundësojnë ofrimin e shërbimeve në familje, në veçanti për fëmijët me aftësi të kufizuara, apo të moshuarit.
- Ndërtimin e shërbimeve të reja për mbrojtjen e fëmijëve, si qendrat e emergjencës për pritjen e shpejtë të rasteve në nevojë për mbrojtje, apo ofrimi i shërbimeve 24 orëshe për ta, për fëmijët 0-14 (strehëza 'Rosalba' e ofron aktualisht këtë shërbim për fëmijët mbi 14 vjeç).
- Përmirësimin e shërbimeve që synojnë fuqizimin e viktimave të dhunës në familje. Ofrimi i banesave sociale është një mbështetje e madhe, pasi pas sigurimit të strehimit, shumë lehtë mund të procedohet me mbështetje të mëtejshme, si kurset profesionale apo punësimi. Aktualisht, në bashkëpunim me OJF-të dhe Zyrën e Punësimit për ndjekjen e kurseve profesionale , vihet re një numër në rritje i të interesuarve për të ndjekur këto kurse, por në shumicën e rasteve mbetet problem strehimi i menjëhershëm. Për këtë Enti Kombëtar i Banesave duhet të japë një fond të veçantë për strehimin social për grupet vulnerabël.
- Ngritja e të paktën një strehëze për gratë dhe vajzat e dhunuara.
- Përmirësimi i cilësisë së jetesës për personat me aftësi të kufizuar, dhe përfshirja e tyre në komunitet. Plani vendor për personat me aftësi të kufizuar i bashkengjitet i detajuar në mënyrë specifike Planit Social.
- Shtimin e shërbimeve terapeutike për fëmijët me Sindromën Doën apo me çrregullime të spektrit autik 0-6 vjeç, pranë qendrës ekzistuese që i ofron këto shërbime(Qendra e

Zhvillimit ditor), pasi numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara për Bashkinë e Lezhës është në rritje ( 291).

- Shtimin e shërbimeve për fuqizimin e personave në nevojë (veçanërisht të rinjve), si krijimi i mëtejshëm i mundësive për kurse profesionale dhe më tej punësim, sidomos për të rinjtë romë dhe egjiptianë (në mbështetje të nismave të ndërmarra deri tani në këtë drejtim).
- Shtimin e shërbimeve për moshën e tretë. Identifikohet nevoja për ndërtimin e të paktën një qendre rezidenciale në nivel Bashkie për të moshuarit pa kujdes (me mbështetjen e pushtetit qendror), si dhe të qendrave ditore komunitare në nivel njësie administrative që ofrojnë shërbime bazë si socializimi dhe shërbimet shëndetësore.
- Zhvillimin e mëtejshëm të programeve të prindërimit të shëndetshëm (nga qendra komunitare), në veçanti për t'u përballur me problemin e martesave të hershme në komunitetin rom.

## 2.3 Partneriteti me OJF-të

OJF-të kanë një rol shumë të rëndësishëm në hartimin e politikave dhe shpërndarjen e shërbimeve. Është një faktor mjaft pozitiv që OJF-të janë përfshirë në hartimin dhe konsultimin e shumë prej strategjive vendore dhe kombëtare.

Në total, në territorin e Bashkisë së Lezhës operojnë 14organizata të shoqërisë civile, një pjesë prej tyre me bazë fetare, nga të cilat 9 ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për mbrojtjen e fëmijëve, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë, etj, ndërsa 5 prej tyre realizojnë aktiviteteve fuqizuese për zhvillimin e komunitetetеve apo target grupeve të caktuara, si gratë dhe vajzat në risk trafikimi dhe ato viktima të dhunës në familje, komunitetin rom dhe egjiptian, fëmijët si edhe familjet e varfra.

Drejtoria e Shërbimit Social gjithashtu bashkëpunon drejtpërsërdrejti dhe ofron mbështetjen e saj për 6 organizata:Ëorld Vision, Terre des hommes, Casa OLA, Kryqi i Kuq dhe Malteser, Shqipëri, duke u ofruar sipas rastit godinën për shërbimet, truallin për ndërtimin e objektit si dhe bashkëfinancuar ndërtimin e objektit dhe ofrimin e shërbimeve. Këto janë organizata jopublike ku me secilën prej tyre është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, me detyrime reciproke, për ofrimin e mbështetjes dhe shërbimeve, si më poshtë:

1. Qendra Komunitare për përmirësimin e kushteve të jetesës për fëmijët dhe familjet e kthyer nga emigracioni në bashkëpunim me Tdh dhe ËV e krijuar gjatë vitit 2017, në të cilën ofrohen shërbime si: fuqizim ekonomik, ndjekje e fëmijëve në nevojë për mbrojtje; aktivitete sensibilizuese, këshilluese për prindërim pozitiv; Lojra psiko-sociale; mbështetje shkollore, etj. Bashkia ka nëshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Terre des hommes, nga Marsi 2016-Dhjetor 2018, me qëllim, koordinimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, veçanërisht në parandalimin e migrimit të pasigurt dhe rintegrimin e migrantëve të kthyer. Gjithashtu, ajo ka nënshkruar një marrëveshje me World Vision (deri në vitin 2020), me qëllim forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve për realizimin e të drejtave të fëmijëve vulnerabël, për më shumë akses në një arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, si dhe ofrimin e shërbimeve të integruara shoqërore.

2. Qendra Ditore e të moshuarve në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, e cila është hapur në vitin 2008 në të cilën ofrohen aktivitete për mbështetje psiko-emocionale dhe aktivitete rekreative për moshën e tretë. Bashkia ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimin me Kryqin e Kuq që nga nëntori 2017-nëntor 2022, me qëllim ofrimin e shërbimeve më cilësore për grupe sociale si të moshuar, gra dhe vajza në nevojë, e familje me vështirësi social-ekonomike.
3. Nga muaji Nëntor 2017, Qendra Komunitare Multidisiplinare për fuqizimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkëpunim me Malteser Shqipëri, në të cilën ofrohen një sërë shërbimesh: a) qendër ditore për parashkollorët, b) mbështetje shkollore pas mësimit c) konsulencë psikologjike dhe juridike për komunitetin d) qendër sportive për komunitetin. Bashkia ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Organizatën Shqiptare të Urdhrit të Maltës nga Nëntori i vitit 2017 (deri në vitin 2027)e qëllim forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për grupet sociale më në rrezik, si fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian, nëpërmjet integrimit të tyre në sistemin edukativ parashkollor dhe shkollor publik.
4. Casa OLA, është qendër për shëndetin e gruas dhe fëmijës, e cila ofron shërbime mjekësore, me mbështetjen e mjekëve italianë, përmes një marrëveshjeje dy vjeçare me bashkinë.

Është i domosdoshëm ndërgjegjësimi mbi shërbimet e disponueshme dhe të drejtën e aksesit ndaj tyre, një rol të cilin deri tani e kanë luajtur kryesisht OJF-të, në kuadër të fokusit të tyre dhe marrëveshjeve me bashkinë Lezhë. Gjithashtu, ato kanë luajtur një rol të rëndësishëm në adresimin dhe referimin e rasteve të ndryshme, përfshi ato të mbrojtjes së fëmijëve, të aftësisë së kufizuar, etj. Për më tepër, OJF-të konsiderohen si një strukturë e rëndësishme në ofrimin e shërbimeve, pasi mund të veprojnë edhe më shpejt se institucionet publike dhe kanë mundësi për të ofruar një cikël të plotë të shërbimeve.

Përfaqësuesit e OJF-ve vlerësojnë përpjekjet e bashkisë në vitet e fundit, e megjithatë theksojnë nevojën për përpjekje më të fuqishme nga ana e saj për të realizuar, sipas legjislacionit përkatës, rolin e saj si ofruesi kryesor i shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke marrë përsipër në këtë kuadër, koordinimin e vazhdueshëm të të gjithë aktorëve, për realizimin e këtij qëllimi.Megjithë kufizimet në shërbimet ekzistuese, përfaqësuesit e OJF-ve identifikojnë mbivendosje në shërbimet që ofrohen nga OJF-të, si rrjedhojë e mungesës së koordinimit mes aktorëve dhe të shkëmbimit të informacionit, që në raste të caktuara sjell mbivendosje, apo trajtimin e një rasti nga një sërë aktorësh të pakoordinuar, ndërkohë që raste të tjera mbeten pa u trajtuar.

## 5. TREGUESIT SOCIALË

Të dhënat e këtij seksioni prezantojnë treguesit socialë në bashkinë e Lezhës. Duhet theksuar se gjatë procesit së mbledhjes së të dhënave u ndeshën një sërë sfidash, siç paraqitet më poshtë:

- Lidhur me të dhënat demografike, janë siguruar të dhëna mbi numrin e popullsisë sipas Njësive Administrative nga Regjistri Civil për 2017 dhe sipas Census 2011. Ndërkohë mungojnë të dhënat e disagreguara si ndarja e popullsisë sipas grupmoshave dhe gjinisë, tipologjia e familjeve, etj. Gjithashtu janë siguruar të dhëna mbi popullsinë dhe territorin si distanca nga qendra në km, sipërfaqja e njësisë në km dhe sipërfaqja e tokës

bujqësore në hektarë. Sipas të dhënave të INSTAT, këto tregues janë në nivel Qarku dhe jo të ndarë sipas çdo bashkie.

- Të dhënat mbi punësimin janë të paplota. Janë siguruar të dhëna mbi punëkërkuesit e regjistruar për të gjithë territorin e bashkisë dhe në nivel qarku, me të dhëna të disagreguara sipas gjinisë, grupmoshës, profilit arsimor dhe kategorive sociale. Ndërkohë mungojnë të dhënat lidhur mbi shpërndarjen e punëkërkuesve sipas sektorëve ekonomikë dhe ndërmarrjet aktive sipas sektorit ekonomik. Të dhënat mbi punësimin i referohen muajit Tetor 2017, sipas Drejtorisë Rajonale të Punësimit Lezhë. Një sfidë për regjistrimin e të papunëve përbënte pamundësia për të regjistruar ata persona të cilët kanë në zotërim tokë bujqësore (e cila është e papërshtatshme për t'u punuar), sipas ligjit 79/95, i cili specifikon se këta persona nuk mund të regjistrohen në sistem apo të përfitojnë shërbime. Sfida tjetër lidhet me mungesën e të dhënave për ish-komunat.
- Të dhënat mbi arsimin. Janë siguruar të dhëna mbi fëmijët e regjistruar në shtator 2017 në të gjitha ciklet e arsimit, pra grupmosha 3-18 vjeç (kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme) sipas shkollave të shpërndara në territor, si edhe për çerdhet, të cilat janë vetëm në qytetin e Lezhës. Informacioni mbi shkollat profesionale është i plotë, pasi mungojnë të dhënat mbi numrin e mësuesve dhe mbi raportin nxënës/mësues. Të dhënat i referohen fillimit të vitit shkollor Shtator 2017 dhe janë siguruar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë.
- Të dhënat mbi shëndetësinë. Janë siguruar të dhënat mbi qendrat shëndetësore dhe ambulancat sipas shpërndarjes në territor, të dhënat mbi mjekët specialistë dhe të dhëna për spitalin rajonal Lezhë të vëna në dispozicion nga Fondi i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor. Ndërkohë mungojnë të dhënat mbi numrin e mjekëve për familje.
- Të dhënat për PAK dhe kujdestarët janë të plota sipas kategorive të përcaktuara të verbër, para tetraplegjikë dhe PAK mendore sipas Njësive Administrative. Është siguruar edhe numri i fëmijëve me AK sipas grupmoshave dhe njësive, si edhe numri i fëmijëve me AK që përfitojnë pagesa sipas njësive.
- Të dhënat mbi fëmijët në territorin e Bashkisë së Lezhës janë të paplota. Është siguruar vetëm numri i fëmijëve sipas kategorive të kërkuara për vitin 2016 si fëmijë në kujdestari, pa kujdes prindëror, fëmijë me AK, etj, por mungojnë të dhënat sipas kategorive, si fëmijë të shfrytëzuar, numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje, numri i fëmijëve të birësuar, etj, sipas NJA-ve. Gjithashtu mungon numri total i fëmijëve 0-18 vjeç sipas grupmoshave dhe shpërndarjes sipas njësive.
- Të dhënat mbi shërbimet janë të plota sipas kategorive të kërkuara si tipologjia, ofruesi, kapaciteti maksimal dhe kapaciteti aktual.
- Të dhënat mbi Ndihmën ekonomike janë të plota të ndara sipas Njësive Administrative, karakteristikave të përfituesve dhe kategorive.

**Tabela e treguesve**

| **Treguesi** | **Niveli i disagregimit** | **Burimi dhe viti i mbledhjes së të dhënave** |
|---|---|---|
| **1.Të dhëna sociale të përgjithshme** | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1.1Papunësia** | | | |
| Papunësia/Punëkërkues të papunë | Total **1310** | | **Burimi:** Raporti i DRP Lezhë<br>**Viti:** Tetor 2017 |
| | Sipas gjinisë | femra 634 | |
| | | meshkuj **676** | |
| Sipas moshës: | Mbi 50 vjeç 526<br>45-50 vjeç 216<br>40-44 vjeç 132<br>35-39 vjeç 102<br>30-34 vjeç 104<br>25-29 vjeç 100<br>20-24 vjeç 113<br>15-19 vjeç 17 | | |
| Sipas arsimit | Më pak se fillore 957<br>Fillore 176<br>9 vjeçare 589<br>E mesme e përgjithshme 242<br>E mesme profesionale 147<br>Arsim universitar 62 | | |
| Të papunë sipas target grupeve | **Sipas moshës:**<br>Punëkërkues Romë 96<br>Punëkërkues Egjiptianë 175<br>Punëkërkues viktima të trafikimit 0<br>Punëkërkues me AK 2<br>Punëkërkues emigrantë të kthyer 11 | | |
| **1.2 Arsimi** | | | |
| Niveli Arsimor | | | |
| Nr. i shkollave | **Shkolla 9-vjeçare**: 48 shkolla<br>6985 nxënës | 542 mësues | **Burimi:** DAR Lezhë<br>**Viti akademik** Shtator 2017 -2018 |
| | **Shkolla të mesme të përgjithshme:**<br>12 shkolla<br>2022 nxënës | 165 mësues | **Burimi:** DAR Lezhë<br>**Viti akademik** Shtator 2017 -2018 |
| | | | **Burimi:**DSHS<br>**Viti:** Shtator 2017 |
| | **Shkolla profesionale:**<br>1 shkolla<br>548 nxënës | Femra 185<br>Meshkuj 363 | |
| Nr. i kopshteve | 45 kopshte | 93 edukatorë | **Burimi:** Bashkia Lezhë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | 1697 fëmijë | | **Viti:** Shtator 2017 |
| Nr. i çerdheve | 1 çerdhe<br>110 fëmijë | 9 kujdestarë | |
| **2. Shërbime kesh** | Total: | 798 | |
| Familjet përfituese të Ndihmës Ekonomike | Sipas vendbanimit | Gjithsej 650<br>Rural 526<br>Urban 124 | **Burimi:**DSHS<br>**Viti:**Maj 2018 |
| | Total të rritur : **1696** | | |
| Nr. i përfituesve PAK | Total fëmijë 0-18 vjeç **296** | | **Burimi:**DSHS<br>**Viti:** Nëntor 2017 |
| | **Sipas kategorisë:**<br>Të verbër 235<br>Para-tertaplegjik 205<br>PAK mendor dhe fizik 1256<br><br>**Fëmijët sipas grupmoshës:**<br>0- 6 vjeç 71<br>6 - 15 vjeç 139<br>15- 18 vjeç 86 | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **3.Shërbimet e kujdesit shoqëror**<br><br>Sipas llojit të shërbimeve | **Total:**<br>Nr. i popullsisë: 108441<br>Nr. i përfituesve të shërbimeve shoqërore: 710 (0,6% e popullsisë)<br>Nr. i përfituesve PAK: 32 përfitues (0.02 % e popullsisë);<br>Nr. i përfituesve të shërbimeve për të moshuarit: 140 përfitues (0.12 % e popullsisë);<br>Nr. i përfituesve të shërbimeve për fëmijët: 347 përfitues (0.31% e popullsisë);<br>Nr. i përfituesve të shërbimeve për gratë e dhunuara dhe viktimat e trafikimit: 7 përfitues (0.006%)<br><br>**Shërbime për të moshuarit:**<br>1 qendër ditore për të moshuarit;<br><br>**Shërbime për fëmijët:**<br>2 qendra rezidenciale jopublike;<br>4 qendra ditore jopublike;<br><br>**Shërbime për PAK:**<br>1 qendër ditore publike;<br>2 qendra ditore jopublike;<br><br>**Shërbime për gratë e dhunuara dhe viktimat e trafikimit:**<br>1 qendër rezidenciale jopublike;<br>1 qendër ditore jopublike;<br><br>**Shërbime për të rinjtë**<br>1 qendër ditore jopublike; | | **Burimi:**DSHS<br>**Viti:** Nëntor 2017<br><br>Burimi:DSHS<br><br>**Viti:** Nëntor 2017 |
| Nr. i përfituesve | Total:<br>Sipas gjinisë | **1159**<br>femra<br>meshkuj | |
| **3.1 Fëmijët** | | | |
| | **313 fëmijë**<br>Komunitar jopublik | **24 fëmijë**<br>Rezidencial Jopublik | |
| | | | |
| **3.2 Gratë** | | | |
| | Sipas llojit të shërbimit | Rezidenciale jopublike<br>**14 gra dhe vajza** | |

DRAFT

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Komunitar jopublik<br>**997 gra** | |
| **3.3 Të moshuarit**<br>Numri dhe lloji i shërbimeve për të moshuarit | | | Burimi:DSHS<br><br>**Viti:** Nentor 2017 |
| | Sipas llojit të shërbimit | 1 shërbim ditor jopublik<br><br>140 përfitues të shërbimit ditor jopublik. | |
| Nr. të moshuarve përfitues | Total | **241** | |
| | Sipas gjinisë | femra | |
| | | meshkuj | |
| | Sipas moshës | | |
| **3.4 FËMIJËT me AK**<br>Nr. dhe lloji shërbimeve për fëmijët me AK | | | Burimi: DSHS<br><br>**Viti:** Nëntor 2017 |
| | Total 296 fëmijë me AK | Sipas Grupmoshës<br>0-6 vjeç 71 Fëmijë<br>6-15 vjeç 139 fëmijë<br>15-18 vjeç 86 fëmijë | |
| | 3 qendra ditore, 1 publike dhe 2 jo publike | | |
| | Sipas llojit të shërbimit | **52 përfitues** – Ditor publik;<br>10 përfitues – ditor jopublik | |
| Nr. i Shërbimeve për komunitetet Rome dhe Egjiptiane | 1 qendër Ditore jopublike<br>90 përfitues anëtarë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane | | Burimi: DSHS<br><br>**Viti:** Nëntor 2017 |
| **3.6 Shërbime për të rinjtë** | | 1 Qendër ditore jopublike<br>50 përfitues | Burimi: DSHS<br><br>**Viti:** Nëntor 2017 |

DRAFT

## 4. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT SOCIAL

LIGJ Nr. 139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE"
Neni24
**Funksionete bashkivenëfushëne shërbimevesociale**
Bashkitëjanëpërgjegjësepërkryerjene këtyrefunksioneve:
1.Krijimindheadministrimineshërbimevesociale,nënivelvendor,përshtresatnënevojë,personat meaftësitëkufizuara,fëmijët,gratë,gratëkryefamiljare,gratëedhunuara,viktimatëtrafikut,nënaap oprindërmeshumëfëmijë,tëmoshuaritetj.,sipasmënyrëssëpërcaktuarmeligj.
2.Ndërtimindheadministriminebanesavepërstrehiminsocial,sipasmënyrëssëpërcaktuarmeligj.
3.Ndërtimindheadministrimineqendravepërofrimineshërbimevesocialevendore.
4.Krijimin,nëbashkëpunimmeministrinëpërgjegjësepërmirëqeniensociale,tëfonditsocialpërfin ancimineshërbimeve,sipasmënyrëssëpërcaktuarmeligj.

### 4.1. Misioni

Misioni i Bashkisë Lezhëështë të vendosë fokusin në shërbimet e kujdesit shoqëror, për të mbuluar nevojat emergjente sociale në rritje të komunitetit, përmes zhvillimit të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe ndërtimit të shërbimeve të reja, sipas modeleve të praktikave të mira bashkëkohore dhe shtrirjes së tyre në njësitë administrative me numër më të madh popullsie si dhe pranë komunitetit, aty ku ai jeton.
***Shërbimesocialemultisektoriale, tëqëndrueshmedhetëstandartizuarapranëkomunitetit, nëmbështetjedhefuqizimtëfamiljessiqelizabazë e shoqërisë.***

### 4.2. Vizioni

Ofrimi i shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse, të besueshme dhe parandaluese me individin ne qëndër dhe menaxhimin e rastitështë vizioni i Bashkise Lezhë, përmes ngritjes së një sistemi të balancuar shërbimesh sociale dhe mbulimit të nevojave materiale të grupeve vulnerabël si dhe vënies në dispozicion me burime njerëzore, materiale dhe financiare të mjaftueshme, për të siguruar shërbime që respektojnë standartet.

## 5. Objektivat

- Objektivi strategjik 1 – Ndërtimi i shportës së shërbimeve të kujdesit shoqëror
- Objektivi strategjik 2 - Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë
- Objektivi strategjik 3 – Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuar
  Objektivi strategjik 4 – Kualifikimi i stafit

***Mbulimi***sa më i plotë i territorit të Bashkisë së Lezhës me shërbime sociale duke u harmoniuar me interest dhe nevojat e komunitetit.
***Gjithëpërfshirja***, pjesëmarrja dhe krijimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit, etj.

***Bashkërendimi*** dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet rajonale në varësi të pustetit qëndror, me bashkitë fqinje dhe shtete të tjera.
Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.
***Vlerësimi***, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe fëmijët në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për një strehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.
Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktivitetevetë edukimit e promocionit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor.

## 5. Plani vendor për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lezhë[1]

Bashkia Lezhëka përgatitur tashmë një plan të veçantë vendor për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, me qëllimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga KDPAK dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore. Ky dokument është hartuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), në partneritet dhe me mbështetjen e Ëorld Vision Albania, dhe me pjesëmarrjen e institucioneve të qeverisjes në nivel vendor. Gjatë fazës së mbledhjes së informacionit dhe diskutimeve me autoritetet vendore, u identifikuan tre fusha kryesore të ndërhyrjes, ku Bashkia Lezhë do të fokusohet gjatë zbatimit të këtij plani, një nga të cilat është *ajo e shërbimeve sociale.*

Vlerësimi i situatës në përgatitjen e këtij plani tregoi se vetë Bashkia, por edhe institucionet me të cilat ajo bashkërendon për të orientuar problematikat e personave me aftësi të kufizuara, duhet tw pwrmirwsojnw standartet e aksesueshmërisë, sikurse parashikuar në kuadrin politik dhe ligjor për të akomoduar personat me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijë me aftësi të kufizuara të të gjitha kategorive. Gjithashtu, shërbimet aktuale që ofrohen në Bashkinë Lezhë duhet tw shtohen për të mbuluar gamën e kërkesave për shërbime si për fëmijë ashtu edhe për të rritur me aftësi të kufizuara.

